



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr.9655, datë 11.12.2006

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(i ndryshuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, me ligjin Nr.9949, datë 7.7.2008, me ligjin Nr.10 271, datë 22.4.2010)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë (në vazhdim Akademia) është institucion shkencor, që vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh.

Neni 2

- 1 Akademia është person juridik publik.
- 2 Akademia e ka selinë në Tiranë dhe ka stemën e vet. Statuti i saj miratohet nga asambleja.

Neni 3

Akademia është institucion autonom, i cili e mbështet veprimtarinë në të vërtetën shkencore dhe në interesat kombëtarë. Ajo vepron sipas ligjeve në Republikën e Shqipërisë dhe statutit të saj.

KREU II FUNKSIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 4

Funksionet

Akademia ka këto funksione:

- a) bashkëpunon me institucione kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, që kanë kapacitetet e nevojshme fizike për kërkim, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës;
- b) propozon fusha të reja kërkimore e studimore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit;
- c) u ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit;
- d) boton organe periodike dhe vepra të tjera me nivel të lartë shkencor;
- e) organizon kongrese dhe konferenca shkencore dhe problemore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;
- f) organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore.

KREU III PËRBËRJA E AKADEMISË

Neni 5

Anëtarët e Akademisë

(i ndryshuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, neni 1)

1. Akademia ka në përbërje anëtarë të rregullt, anëtarë të përhershëm, anëtarë të asociuar dhe anëtarë nderi.
2. Anëtarët e rregullt të Akademisë mbajnë titullin “Akademik” dhe të tillë janë 30 veta. Në këtë grup përfshihen edhe Anëtarët e përhershëm të Akademisë dhe të tillë janë deri në 10 veta.
3. Anëtarët e asociuar të Akademisë mbajnë titullin “Akademik i asociuar” dhe të tillë janë 15 veta.
4. Anëtarë nderi të Akademisë janë personalitete të njohura të vendeve të tjera. Numri i tyre përcaktohet në statutin e Akademisë, por ky numër nuk e kalon atë të anëtarëve të rregullt të Asamblesë së Akademisë”.

Neni 6

Përzgjedhja e anëtarëve

(ndryshuar me ligjin Nr.9949, datë 7.7.2008, neni 1)

Anëtarët e rregullt të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve të shquar me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve origjinale, veprave përgjithësuëse, me një nivel të lartë shkencor, kanë zgjidhur, teorikisht dhe praktikisht, probleme të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencës, të ekonomisë, artit dhe kulturës, si dhe kanë dhënë ndihmesë në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të rregullt të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve të shquar shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, që punojnë aktualisht pranë universiteteve dhe qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”.

Në raste të veçanta, anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen edhe personalitete me merita të shquara në fusha të ndryshme të krijimtarisë.

Anëtarët e përhershëm të akademisë zgjidhen akademikët që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe kanë një kontribut të shquar, të vlerësuar gjerësisht, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve dhe veprave shkencore, kanë dhënë ndihmesë të rëndësishme në zhvillimin e shkencës dhe formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, që punojnë aktualisht pranë universiteteve e qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”.

Anëtarët e nderit zgjidhen nga radhët e personaliteteve të njohura të vendeve të tjera, të cilët kanë dhënë kontribut të shquar në zhvillimin e vendit tonë.

Personat, që kanë funksione të larta administrative dhe politike, nuk mund të kandidojnë për tu zgjedhur anëtarë të rregullt dhe të asociuar të Akademisë gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve.

Procedurat për zgjedhjen e anëtarëve përcaktohen në statutin e Akademisë.

Neni 6/1
Përfundimi i anëtarësisë në Akademi dhe
plotësimi i vendeve vakante
(shtuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, neni 3)

1. Statusi i anëtarit të rregullt, atij të asociuar, dhe i çdo funksioni tjetër drejtues të lidhur me këto funksione në zbatim të neneve 9 dhe 10 të këtij ligji, përfundon kur anëtari:

- a) mbush moshën 75 vjeç;
- b) jep dorëheqjen;
- c) zgjidhet apo emërohet në funksione drejtuese në parti politike apo organe kushtetuese;
- ç) deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- dh) shkarkohet me dy të tretat e votave të gjithë anëtarëve të Asamblesë për akte e sjellje që cenojnë rëndë figurën e anëtarit të Akademisë; ose
- e) ndërron jetë.

2. Statusi i anëtarit të përhershëm përfundon kur vërtetohet një nga rastet e mësipërme me përjashtim të atij të parashikuar në shkronjën “a”.

3. Statusi i anëtarit të nderit përfundon kur vërtetohet një nga rastet e mësipërme përjashtuar ato të parashikuara në shkronjat “a” dhe “c”.

4. Procedurat për plotësimin e vendit vakant, të krijuar për shkak përfundimi të funksionit sipas pikës 1 të këtij neni, fillojnë jo më vonë se dy muaj para përfundimit të funksionit sipas shkronjës “a” dhe jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tij, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, dhe “e” të pikës 1 të këtij neni”.

Neni 7
Shpërblimi i anëtarëve
(ndryshuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, neni 4)

1. Pranimi në Akademi si anëtar i rregullt, i përhershëm apo i asociuar nuk nënkupton një vend pune me kohë të plotë dhe të pagueshëm në Akademi.

2. Anëtarët e Akademisë që kanë vende pune me kohë të plotë dhe të pagueshme në Akademi janë anëtarët e kryesisë dhe drejtuesit e seksioneve.

3. Nga buxheti i Akademisë paguhet shpërblimi për titullin “Akademik” dhe mbështetet veprimtaria akademike anëtarëve të rregullt, të përhershëm, të asociuar dhe anëtarëve të nderit që nga momenti i pranimit në Akademi deri në ndërprerjen e anëtarësisë në të për shkaqet e parashikuara në nenin 6/1, shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “e”.

4. Anëtarët e rregullt të Akademisë, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që janë në marrëdhënie pune, krahas pagës, sipas vendit të punës

përfitojnë edhe shpërblim mujor për titullin “Akademik” në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ata, krahas pensionit që u takon si profesor, marrin edhe shpërblimin për titullin “Akademik”.

5. Akademikët e Asociuar përfitojnë një shpërblim mujor në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

(shtuar me ligjin Nr.10 271, datë 22.4.2010, neni 1)

Neni 8

E drejta e pensionit

(shfuqizuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, neni 5)

KREU IV

ORGANET DREJTUESE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 9

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Akademisë janë asambleja, këshilli ekzekutiv dhe kryesia.

Përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të këtyre organeve drejtuese përcaktohen në statutin e Akademisë.

Neni 10

Përbërja e organeve drejtuese

(ndryshuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, neni 6)

1 Asambleja është organi më i lartë drejtues i Akademisë dhe përbëhet nga anëtarët e rregullt, anëtarët e përhershëm dhe anëtarët e asociuar të Akademisë”.

2 Këshilli ekzekutiv përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari, Sekretari Shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.

3 Kryesia e Akademisë përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Sekretari Shkencor.

Neni 11

Mënyra e zgjedhjes së Kryesisë

(ndryshuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, neni 7)

1. Kryetari i Akademisë përzgjidhet drejtpërdrejt me votim të fshehtë nga Asambleja, nga radhët e anëtarëve të rregullt ose të përhershëm. Kryetar zgjidhet

kandidati, i cili merr më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë. Kryetari i zgjedhur nga Asambleja emërohet nga Presidenti i Republikës.

2. Zëvendëskryetari, Sekretari Shkencor dhe drejtuesit e seksioneve përzgjidhen drejtpërdrejt me votim të fshehtë nga Asambleja, nga radhët e anëtarëve të rregullt, të përhershëm ose të asociuar, sipas procedurave të përcaktuara në statutin e Akademisë.

3. Kohëzgjatja e mandatit të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa e Sekretarit Shkencor dhe e drejtuesve të seksioneve është 5 vjet. Në çdo rast, kohëzgjatja e mandatit të Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe Sekretarit Shkencor nuk tejkalon kohëzgjatjen e statusit të anëtarit të rregullt ose të asociuar, në përputhje me nenin 6/1 të këtij ligji.

4. Kryetari, Zëvendëskryetari, Sekretari Shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të zgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate, por jo radhazi.

Neni 12

Strukturat mbështetëse

Kryesia e Akademisë, në ushtrimin e veprimtarisë mbështetet nga administrata, struktura dhe organika e së cilës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

SEKSIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 13

Seksionet dhe përbërja e tyre

1. Veprimtaria e Akademisë zhvillohet në kuadër të seksioneve, të cilat janë bartëse të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësive të Akademisë për fusha të ndryshme të shkencës.

2. Detyrat, përgjegjësitë, përbërja, mënyra e drejtimit dhe e funksionimit të seksioneve përcaktohen në statutin e Akademisë.

KREU VI

Neni 14

Financimi

1. Akademia është një institucion buxhetor dhe të ardhurat i siguron nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) shërbimet tekniko-shkencore, që kryhen për persona juridikë e fizikë jashtë sistemit të saj;
- c) aplikimet, projektet, dhuratat subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Të ardhurat e krijuara sipas shkronjave “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 14/1

Raportimi i Akademisë së Shkencave

(shtuar me ligjin Nr.10 271, datë 22.4.2010, neni 1)

Akademia e Shkencave paraqet, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti, informacion për veprimtarinë vjetore pranë Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 15

Struktura dhe organizimi i Akademisë, si edhe statuti i saj të përshtaten në përputhje me këtë ligj brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Akademia e riorganizuar zhvillon zgjedhjet e organeve drejtuese brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 16

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 e 12 brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17

Shfuqizime

Ligji nr.9182, datë 5.2.2004 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Botuar në Fletoren zyrtare nr.146, dhjetor 2006.